

**Komentet e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Eugen Wollfarth, për median gjatë vizitës në Fier**

*2 mars 2012*

**Pyetje:** Serbisë iu dha dje statusi i vendit kandidat ndërkohë që Shqipërisë mund t'i refuzohet ky status për të tretën herë.

**Ambasadori Wollfarth:** Ky është pa dyshim një vendim i Bashkimit Evropian, i cili është marrë mbi bazën e një rekomandimi të ardhur nga Komisioni Evropian. Është me rëndësi që të mendohet për integrimin si për një çështje kombëtare dhe që ai të bëhet një çështje kombëtare, ndër të parat çështje, në mos po e para çështje në agjendën e vendit. Natyrisht për këtë nevojitet para së gjithash një përpjekje e përbashkët nga ana e udhëheqësve politikë shqiptarë dhe është pa dyshim një hap që duhet ta hedhin shqiptarët të parët, duke arritur rezultate në reformat që e çojnë vendin përpara, sidomos në drejtim të procesit të integritimit Evropian. Mendoj se është me rëndësi të posaçme hedhja e këtyre hapave përpara.

**Pyetje:** Po për reformën zgjedhore ç'mund të na thoni? Kuvendi sapo vendosi zgjatjen për dy muaj të tjerë të mandatit të komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore.

**Ambasadori Wollfarth:** Është një hap i rëndësishëm. Ajo që nevojitet patjetër të shohim tani është një punë cilësore në këtë drejtim, kjo është pikërisht ajo që pret edhe kombi. Jam tepër i sigurt se të dyja palët, të dyja kampet politike do të paraqesin propozime shumë të mira dhe do t'i miratojnë ato në kohën e duhur. Prezenca e OSBE-së dhe ODIHR-i e mbështesin këtë proces dhe do të vazhdojnë të mbështesin atë edhe më tej.

**Pyetje:** Z. Ambasador, a mendoni se konsensusi i arritur dje në mbledhje mes palëve në Kuvend është një hap përpara drejt integritimit të vendit dhe si e vlerësoni ndryshimin e qëndrimit nga ana e PS-së në Kuvend?

**Ambasadori Wollfarth:** Sipas mendimit tim, është një hap i rëndësishëm përpara. Lejomëni të përdor fjalën bashkëpunim në këtë rast. Bashkëpunimi i mirë në Kuvend mes pozitës dhe opozitës nevojitet për të çuar përpara projekte të rëndësishme, e sidomos nismat ligjore. Kjo gjë ndodhi në Kuvend në lidhje me një çështje të rëndësishme dhe jam i bindur se do të ketë një vlerësim pozitiv për këtë. Nevojiten edhe shumë hapa të tjerë për ta çuar vendin përpara. Shpresoj dhe jam optimist se do të shohim këtë të ndodhë, për shembull edhe në reformën e kodit zgjedhor si dhe në atë parlamentare. Dhe unë shpresoj gjithashtu se është një hap i mirë, një hap historik, mirëpo, natyrisht nuk është fundi i gjithçkaje, por një kapitull që duhet pasuar prej kapitujsh të tjerë. Mirëpo, është një hap inkurajues, jashtëzakonisht pozitiv, dhe jam i kënaqur për të.

**Pyetje:** Sipas mendimit tuaj, ç'duhet të bëjnë palët me ligjet për miratimin e të cilave nevojitet një shumicë e cilësuar?

**Ambasadori Wollfarth:** Bashkëpunimi konstruktiv mes palëve është qëndrimi më i mirë që mund të mbahet tani. Vendi i nevojiten kontribute të matura, të mira dhe të mençura nga ana e të gjitha partive politike, veçanërisht prej partive më të mëdha, por edhe partitë e vogla politike mund të japin kontributin e tyre, sepse nuk ka kufi për idetë e mira dhe për

bashkëpunimin e mirë. Po ashtu, i gjithë populli, të gjithë shqiptarët anembanë vendit, do të përfitonin, duke fituar një cilësi më të mirë jete në sajë të një procesi të suksesshëm të integritimit. Pra, emri i lojës është bashkëpunim, duhet të punojmë të gjithë së bashku në të mirë të së ardhmes së përbashkët.

**Pyetje:** Ç'mendim keni për ndryshimin e papritur të qëndrimit nga ana e PS-së në seancën plenare në Kuvend?

**Ambasadori Wollfarth:** Varet se si e sheh... Nuk do ta quaja kështu. Gjithçka varet nga drafti që është sjellë për miratim, nëse është një draft i mirë mund ta votosh menjëherë, por nëse drafti nuk është edhe aq i mirë, atëherë ia vlen të negociosh në lidhje me përmbajtjen e tij. Kështu që do të thosha se në demokraci një gjë e tillë është normale. Me rëndësi është që të kemi projekte cilësore. Vërtetë koha është një faktor, por është vetëm një prej faktorëve. Cilësia mbi gjithçka.

**Pyetje:** Z. Ambasador, bë të një prezantim të shkurtër rreth historikut. Si e vlerësoni respektimin e të drejtave dhe lirive në Shqipëri?

**Ambasadori Wollfarth:** Natyrisht ato kanë një rëndësi të veçantë për ne dhe ne kujdesemi për të drejtat e njeriut në të gjitha fushat, madje edhe në sistemin e burgjeve. Faleminderit.

**E.o.T**